

## **STATUTI**

### **I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR “INKOLI”**

#### **I. THEMELIMI**

##### **Neni 1 Ortaku themelues**

Sot më datë 15.03.2023 z. Feliks Çaçi, i biri i Pandit, lindur në Tiranë më datë 03.04.1966, mbajtësi i kartës së identitetit me nr. 035804333 banues në adresën rr. “Njazi Demi” Nd. 14, H.15, Ap.9. Njësia Administrative Nr. 5, 1022, Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

#### **II. EMËRTIMI– FORMA LIGJORE– SELIA – OBJEKTI**

##### **Neni 2 Emërtimi**

Shoqëria emërohet “INKOLI” SHPK.

##### **Neni 3 Forma ligjore**

Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar (SHPK), në bazë të ligjit nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjeter me vendimin e Asamblesë së Ortakëve/Ortakut sipas parashikimeve ligjore të ligjit nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

##### **Neni 4 Baza ligjore**

Shoqëria “INKOLI” SHPK do të kryejë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, ligjit nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar.

##### **Neni 5**



## **Selia**

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën rr. "Njazi Demi" Nd. 14, H.15, Ap.9. Njësia Administrative Nr. 5 1022, Tiranë.

Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është [felikscaci@gmail.com](mailto:felikscaci@gmail.com).  
Tel: 069 20 82 858.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë degë dhe filiale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj.

## **Neni 6 Emblema dhe vula**

Shoqëria do të ketë vulën e saj që do të përdoret nga administratori. Forma e vulës dhe masa e saj do të përcaktohen nga Ortaku i vetëm në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

## **Neni 7 Objekti**

Objekti i veprimitarië do të jetë:

- A. Veprimitari në fushën e ndërtimit, duke kryer punime dhei, punime inxhnierike per rrjetin e ujesjelles-kanalizimit te jashtme dhe te brendshme, punime shtresash e izolime, sistemime, taracime terrenesh, punime rifiniture e muresh, murature betoni, beton arme të zakonshme dhe speciale një dhe shumekateshe, punime shembjesh, blerje dhe shitje materiale ndërtimi, ndërtimë civile, industriale, turistike, bujqësore, punime restaurimi, mirëmbajtje e punime shërbimi të zakonshme të sistemit komunal etj.
- B. Veprimitari në fushën e pasurive të paluajtshme, blerjes, shitjes, investimit dhe zhvillimit të tyre, duke përfshirë këtu qendrat tregtare, banesa të përbashkëta, ndërtesat me apartamente, ndërtesat në bashkëpronësi ose individuale, si dhe zhvillimin e trojeve të pazhvilluara me ose pa ndërtim në to.
- C. Tregtimi i lëndëve të para ndërtimore, import, eksport, tregti me shumicë e pakicë të materialeve të ndryshme ndërtimore etj.
- D. Mbikqyrje të ndërtimit të pasurive të paluajtshme civile, industriale, ushtarake, banesa, hotele, objekte kulti, rrugë, infrastrukturë etj.

Objekti i veprimitarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve/Ortakut të vetëm.


## **III. KOHËZGJATJA**

### **Neni 8 Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pakufizuar.

## **IV. KAPITALI**

### **Neni 9**



## **Kapitali themeltar**

Kapitali fillestar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë, tërësisht i shlyer nga ortaku i vetëm përpëra regjistrimit të shoqësisë. Pjesemarja e ortakeve themelues ne kapitalin e shoqerise eshte si me poshtë :

**Ortaku themelues Feliks Çaci,** zotëruesh i 1(nje) kuote me vlerë 100 000(njeqind mijë) leke , i cili zoteron 100% pjesë të kapitalit themeltar te shoqerise.

## **V. VENDIMMARRJA - ADMINISTRIMI**

### **Neni 10**

#### **Ortaku i vetem**

Vendimet kryesore mbi veprimtarine e shoqerise merren nga Ortaku i vetem.

Vendimet e Ortakut te vetem drejtojne veprimtarine e shoqerise.

Vendimet e Ortakut te vetem perfshijne kryesisht:

- ndryshimin e selise dhe emertimin te shoqerise
- rritjen ose zvogelinin e kapitalit themeltar te shoqerise
- shitjen ose transferimin e pjesave te kapitalit themeltar paleve te treta
- prishjen dhe likuidimin e shoqerise
- emerimin ose shkarkimin e administratorit te shoqerise
- miratimin e bilancin te shoqerise
- transformimin e shoqerise ne forma te tjera

### **Neni 11**

#### **Administratori**

Administratori i shoqerise emerohet dhe shkarkohet nga Ortaku i vetem.

Administratori i shoqerise eshte z. Feliks Çaci, i biri i Pandit, lindur në Tiranë më datë 03.04.1966, mbajtësi i kartës së identitetit me nr. 035804333 banues në adresën rr. "Njazi Demi" Nd. 14, H.15, Ap.9. Njësia Administrative Nr. 5 1022, Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Administratori i shoqerise eshte i zgjedhur per 5(pese) vjet dhe me te drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i shoqerise eshte perfaqesues ligor dhe perfaqesues i shoqerise ne marredhenie me te tretet,me perjashtim te kompetencave qe ligji ua njeh shprehimisht Ortakeve.

Administratori ekzekuton Vendimet e Asamblese te Ortakeve/Ortakut,duke raportuar periodikisht para tyre.

Ne kompetence te administratorit perfshihen:

- kryerja e te gjitha veprimeve te administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise,duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga Asambleja e Ortakeve/Ortakut
- perfaqeson shoqerine tregtare
- kujdeset per mbajtjen sakte e te regullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise
- perqatit dhe nenshkruan bilancin vjetor,raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per ndarjen e fitimeve,i paraqit keto dokumente perpara Asamblese se Ortakeve/Ortakut per miratim



- te paralajmeroje ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise.

#### **Neni 12**

#### **Pergjegjesite e administratorit**

Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise per shkelje te ligjeve,te statutit si dhe per faje te kryera gjate administrimit te tij.

Administratori gjate kryerjes se detyrave,pergjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim,qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare,me perjashtim te rasteve kur veprimi ose mosveprimi eshte kryer me mirebesim.

Ne cdo rast shkarkimi i administratorit mund te behet ne cdo kohe nga Ortaku i vetem.

### **VI. VITI FINANCIAR-LIKUIDIMI**

#### **Neni 13**

#### **Viti finanziar**

Viti finanziar i shoqerise perputhet me vitin kalendarik,duke filluar nga 1 janari dhe mbaron me 31 dhjetor.

#### **Neni 14**

#### **Bilanci.Mbajtja e kontabilitetit.**

Bilanci vjetor i Shoqerise shqyrtohet ne mbledhjet e Ortakut te Vetem dhe duhet te hartohet per t'iu paraqitur organeve tatimore brenda afateve te percaktuara nga ligji.

#### **Neni 15**

#### **Te ardhurat.Dividenti.**

Shoqeria do te krijoje fonde rezerve per realizimin e objektit te saj.Shoqeria nga fitimi i rezervuar gjate vitit finanziar,pasi te jene zbritur po te jete e nevojshme humbjet e vitit te meparshem,le menjane nje shume me vlera 1/20 e tij.

Kjo lenie menjane nuk eshte me e detyrueshme kur "Rezerva e Domosdoshme " arrin 1/10 e kapitalit themeltar.

Te ardhurat qe do te rezultojne ne fund te mbylljes se cdo ushtrimori,pas pagimit te tatimeve,mund te ndahen ndermjet ortakeve ne raport me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin e shoqerise.

#### **Neni 16**

#### **Likuidimi**

Shoqeria do te hyje ne procesin e likuidimit,nese:

-Ortaku i Vetem vendose te prishe shoqerine

- ne kushtet e mosarritjes se zgjidhjes se mosmarreveshjeve,sic parashikohet ne Statutin e shoqerise.



Ne menyre qe te ndermarre procedurat e likuidimit,Ortaku i Vetem emeron nje likuidator ose nje grup likuidatoresh.

Likuidatori/likuidatoret do te raportojne mbi gjendjen e zerave te aktivit dhe pasivit te shoqerise rreth operacioneve te metejshme te likuidimit dhe kohen qe nevojitet per perfundimin e tij.Ne fund te procesit,Ortaku i Vetem i Shoqerise shqyrton bilancin perfundimtar dhe mbylljen e procedures se likuidimit.

**Neni 17**

**Zgjidhja e mosmarreveshjeve.**

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise,zgjidhen me mirekuptim,ne te kunderten,kompetente per zgjidhjen e tyre jane Gjykatat Shqiptare.

**Neni 18**

**Ligji i aplikueshem**

Çfare nuk eshte e parashikuar shprehimisht ne kete statut,do te rregullohet ne perputhje me dispozitat e ligjit nr. 9901,date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare"

**Neni 19**

**Pavlefshmeria**

Ne rast se ndonje nga nenet e ketij statuti do te jete i pavlefshem,i paligjshem ose i pazbatueshem,atehere ky nen nuk do te konsiderohet,ndersa te gjitha nenet e ketij statuti do te mbeten ne fuqi dhe te vlefshem.

**Neni 20**

**Dispozita Perfundimtare**

Ky Statut hartohet ne 4(kater) kopje ne gjuhen shqipe me fuqi te njejtligjore.

**ORTAKU**

**Z.Feliks Çaci**

Feliks Çaci